



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. K2/H2-12 Prot.**  
**Nr. Dok. 202100460/12**

**Tiranë 20/12/2021**

**Lënda :** *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për dhënien e kopjes së dosjes personale shtetasit H.Sh..*

**GARDËS SË REPUBLIKËS**  
**Tiranë**

Për dijëni : Z. H.Sh.  
Petrel

Tiranë

Me shkresat nr. K2/H2-2 prot., datë 26.03.2021 dhe nr. K2/H2-3 prot., datë 19.05.2021 ju kemi vënë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi H.Sh.. Ankuesi shkruan se pas 15 vjetësh punë në Policinë e Shtetit, në vitin 2013 është punësuar në Gardën e Republikës, në Batalionin e III-të, me gradën "Kapter i IV". Sipas tij, në vitin 2014 ai është interesuar për rritjen në gradë dhe për këtë ka takuar Shefin e Personelit, i cili i ka thënë që të priste pak kohë sepse do të bëhej njësimi i gradave të Gardës së Republikës me ato të Policisë së Shtetit. Për këtë problem ai ka takuar edhe Zv/Komandantit e Gardës së Republikës.

Meqënëse koha po kalonte dhe grada nuk po i jepej, ankuesi ka rimarrë takim me Shefin e Personelit, i cili përsëri i ka thënë që të priste me justifikimin se do të bëhej njësimi i gradave me ato të Policisë së Shtetit. Ankuesi i ka bërë të ditur Shefit të Personelit se kolegu i tij Afrim Demiraj, me të cilin ishte punësuar në të njëjtën datë, e kishte marrë gradën. Shefi i Personelit pasi ka verifikuar dosjen e z. Afrin Demiraj ka konstatuar se atij i ishte dhënë grada. Ndodhur përballë këtij fakti Shefi i Personelit i ka thënë ankuesit se ai kishte pengesë ligjore dhe ishte penalizuar sepse në dosjen e tij kishte një shkresë

sekrete e cila kishte ardhur nga Komisariati i Policisë nr. 1 Tiranë me të cilën nuk mund të njihej.

Ankuesi ka kërkuar që të njihej me dosjen e tij, por ajo nuk i është dhënë. Sipas ankuesit, ai ka kërkuar disa herë që të takohet me Komandantin e Gardës së Republikës, por nuk është pritur prej tij. Kjo ka sjellë si pasojë që atij nuk i është dhënë mundësia që të njihet me këtë shkresë të pretenduar dhe nëse ekziston ta kundërshtojë atë në rrugë administrative dhe/ose gjyqësore.

Gjithashtu ankuesi pretendon se ndonëse ka një vjetërsi prej 15 vjetësh në Policinë e Shtetit dhe 7 vjet në Gardën e Republikës, por grada që i takon me ligj nuk i është dhënë, ndërkohë që disa kolegëve të tij të ardhur nga Policia e Shtetit dhe nga Forcat e Armatosura u janë dhënë gradat që u takojnë.

Përveç sa më sipër, ankuesi shkruan se për këto shqetësime ka bërë disa ankesa drejtuar Komandantit të Gardës së Republikës dhe Ministrin të Brendshëm, por ende ato nuk i janë zgjidhur.

Me shkresën tuaj nr. 470/2 prot., datë 01.06.2021, ndërmjet të tjerave u informuam se, ankuesi është punësuar në Gardën e Republikës me urdhrin nr. 3692, datë 18.12.2013, i është dhënë grada “Rreshter” dhe emëruar në funksionin organik “Gardist profesionist shërbimi në Njësinë e Dytë”, pozicion që përputhej me gradën që mbante në polici.

Në momentin e pranimit të një punonjësi të Policisë së Shtetit apo të Forcave të Armatosura në Gardën e Republikës, njësimi i gradave bëhet me urdhër të Komandantit të Gardës pas propozimit të organit të emërtesës. Ankuesi është njohur me urdhrin e pranimit dhe gradën, për të cilën ka firmosur, dhe nuk ka pasur pretendime. Nëse ai do të kishte pretendime duhet të kishte ndjekur rrugën ligjore.

Në nenin 22 të ligjit nr. 9366, datë 31.03.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës” parashikohet se:

*“1. Për mosmarrëveshjet, që lindin gjatë procedurave të dhënies së gradës, oficeri dhe nënoficeri i Gardës kanë të drejtë të ankohen te Ministri i Rendit Publik brenda 10 ditëve. Ministri i Rendit Publik duhet të japë përgjigje brenda 30 ditëve.*

*2. Kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen sipas pikës 1 të këtij neni, oficerit dhe nënoficerit të Gardës u lind e drejta të ankohen në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.”*

Në vijim të kësaj përgjigjeje u informuam se ligji i cituar më sipër nuk ofron asnjë mundësi tjetër për marrjen e gradës përveçse nëpërmjet procesit të konkurimit. Pas marrjes së gradës “Rreshter”, në momentin e pranimit në Gardë, ankuesi ka ndjekur procedurën e konkurimit për gradën e radhës dhe me urdhrin nr. 1781, datë 19.09.2017 ka marrë gradën “Kapter i katërt”.

Në takimet që ju ai ka pasur me punonjësit e Sektorit të Burimeve Njëzore, i është kërkuar që të vinte në dispozicion praktikën shkresore për ankimin e bërë sipas ligjit, si korrespondencën me Ministrin e Brendshëm dhe/ose vendim të Gjykatës Administrative,

nëse e ka ushtruar këtë të drejtë ligjore lidhur me gradën, por deri më tani nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumenti.

Ndërsa lidhur me pretendimin se nuk është lejuar të njihet me dosjen personale apo me dokumentin sekret që i është thënë nga Shefi i Sektorit të Burimeve Njërëzore, u informuam se ai nuk qëndronë.

Përveç sa më sipër u informuam se punonjësit e Gardës përveç aksesit që kanë për të parë dosjen personale në hard copy, kanë akses edhe në dosjen e tyre në variantin elektronik, e cila pasqyron të gjithë veprimtarinë e ushtarakut.

Referuar përgjigjes tuaj, nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në përgjigjen e dërguar ankuesit ndërmjet të tjerave i sugjeruam që pasi të merrte përgjigjen tonë të paraqitej në Sektorin e Burimeve Njërëzore të Gardës dhe të bënte kërkesë për njohjen me dosjen e tij personale dhe për të marrë një kopje të saj.

Ankuesi pasi mori përgjigjen tonë na u drejtua përsëri me ankesë në të cilën shkruan se, është paraqitur Sektorin e Burimeve Njërëzore të Gardës së Republikës dhe ka kërkuar të njihet me dosjen e tij. Ajo i është dhënë dhe pasi ai e ka parë atë, ka konstatuar se ndodhej edhe një shkresë e dërguar nga Komisariati i Policisë nr. 1 Tiranë, e cila cenonte personalitetin e tij. Kjo shkresë ishte dërguar për të nxitur Komandantin e Gardës së Republikës për të pezulluar atë nga detyra deri në përfundim të ndjekjes penale, por në fakt ndaj tij nuk ka pasur ndonjë procedim penal dhe as kallëzim në organet e policisë dhe prokurorisë. Ndërkohë për shkak të kësaj shkrese ai nuk është pajisur me armë gjatë shërbimit duke i cenuar sigurinë dhe rrezikuar jetën gjatë kryerjes së detyrës.

Pasi u njohë me dosjen e tij, ai ka kërkuar kopjen e saj, por ajo nuk i është dhënë me justifikimin se nuk e lejon ligji por pa i referuar se cili është ky ligj. Gjithashtu ankuesi shkruan se kopjen e saj e do për t’u konsultuar me një avokat me qëllim pastrimin e dosjes dhe të dhënave të pavërteta e të pasakta që dëmtojnë personalitetin, karrirën dhe interesat e tij.

Në bazë të kërkesës tone të përsëritur, ju me shkresën nr. 1615/1 prot., datë 05.10.2021 ndërmjet të tjerave na informuat se ankuesi është paraqitur në Sektorin e Burimeve Njërëzore dhe në bazë të kërkesës së tij është njohur me dosjen personale. Dosja e tij, sikurse çdo dosje personale e punonjësve të Gardës së Republikës, ka në faqen e parë inventarin e materialeve dhe në brendësi çdo dokument të listuar në këtë inventar, dokumente që i janë vënë në dispozicion.

Gjithashtu ju na informuat se dokumenti që pretendon ankuesi se është dërguar nga Komisariati i Policisë nr. 1 Tiranë, nuk është pjesë e dosjes së tij personale dhe se pretendimi i tij lidhur me ekzistencën dhe mos dhënien e këtij dokumenti është i pa bazuar.

Ndërsa lidhur me pretendimin e ankuesit se nuk i është dhënë kopja e dosjes së tij personale, u informuam se ai nuk ka kërkuar kopjen e saj, por vetëm kopje të dokumentit të pretenduar të cituar më sipër.

Bashkëlidhur me përgjigjen ju na dërguat edhe fotokopje të fletës së inventarit të dosjes personale të ankuesit. Nga përmbajtja e dokumenteve të regjistruara në këtë fletë inventari, nuk rezulton që të jetë pjesë e dosjes shkresa e pretenduar nga ana e tij, dërguar nga Komisariati i Policisë nr. 1 Tiranë.

Pas përgjigjes tuaj të dytë ne e vumë në dijeni ankuesin dhe i sugjeruam që, nëse do të kishte interes të paraqitej në Sektorin e Personelit të Gardës së Republikës dhe bënte kërkesë për të marrë një fotokopje të dosjes personale.

Ditët e fundit, shtetasi H.Sh. na është drejtuar përsëri me ankesë nëpërmjet të cilës na ve në dijeni se i ka ribërë kërkesë me shkrim Sektorit të Burimeve Njëzore të Gardës së Republikës për t'i dhënë kopjen e dosjes së tij, por ndonëse ka kaluar edhe afati ligjor, ajo nuk i është dhënë ende.

Pas shqyrtimit të ankesës së shtetasit H.Sh. dhe të përgjigjeve të dërguara nga ana juaj konstatojmë se, pretendimet e ankuesit se atij nuk i është dhënë dokumenti i kërkuar (dosja personale), janë të vërteta. Nga përgjigjet tuaja nuk rezulton që të ketë ndonjë pengesë ligjore për dhënien e dosjes personale ankuesit. Ndërkohë nga ana juaj nuk na u dërgua kopja e kërkesës së ankuesit drejtuar strukturave të institucionit tuaj. Kjo kërkesë është shumë e rëndësishme për të provuar pretendimet e ankuesit nëse ai ka kërkuar vetëm njohjen me dosjen e tij personale, sikurse na informoni ju në përgjigjet e dërguara, apo edhe dhënien e kopjes së saj. Po kështu, ju nuk na dërguat as kopje të ndonjë dokumenti sikurse mund të jetë procesverbal i nënshkruar edhe prej tij, libër korrespondence, etj., që të provohet fakti se ankuesit i është dhënë kopja e dosjes së kërkuar. Ne vlerësojmë se qëndrimi i mbajtur në këtë rast nga strukturat e Gardës së Republikës përbën cenim të të drejtës së informimit të ankuesit dhe është në kundërshtim të plotë dhe të hapur me disa akte normative në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe konkretisht:

1. Me nenin 23, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar.<sup>1</sup>

2. Me nenin 10, pika 1 të të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.<sup>2</sup>

3. Me nenin 12 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe me disa dispozita të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” sepse:

a) Kërkuesi i dokumenteve që ndodhen në dosjen e tij personale është vetë subjekti/titullari i të dhënave dhe jo ndonjë person tjetër.

<sup>1</sup> E drejta e informimit është e garantuar.

<sup>2</sup> Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë .....

b) Nëse përgjigjet e dërguara institucionit tonë lidhur me këtë ankesë janë korrekte, atëhere rezulton se në dosjen personale të ankuesit nuk ka të administruar ndonjë dokument të klasifikuar si “sekret shtetëror”.

c) Në rastin konkret, nga institucioni juaj nuk duhet zbatuar kufizimi i parashikuar në nenin 12, pika 3 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”,<sup>3</sup> i ndryshuar, dhe neni 17, pika 1, gërmat a, b, c, ç, d, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sepse dhënia e këtij dokumenti/informacioni nuk çënon interesat e sigurisë kombëtare, politikën e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale apo të drejtën për një jetë private, sekretin tregtar, të drejtën e autorit dhe patentat. Pra, nuk ekziston asnjë arsye ligjore për mos dhënien e saj.

ç) Nga strukturat e institucionit tuaj nuk është zbatuar detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 12, pika 2, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”,<sup>4</sup> i ndryshuar, për informimin e kërkuarit (subjektit të të dhënave) nga kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, apo për arsyet e mosdhënies së dokumentit/informacionit të kërkuar.

dh) Nga strukturat tuaja nuk është zbatuar detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 6, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative<sup>5</sup> për të marrë një vendim të arsyetuar me shkrim për refuzimin e informacionit të kërkuar, i cili duhet të përmbajë edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe t’i njoftojë menjëherë kërkuarit.

e) Mosinformimi i kërkuarit nga strukturat e Gardës së Republikës për refuzimin e bërë në fakt për dhënien e dokumentit të kërkuar, ka sjellë si pasojë çënimin e të drejtës së tij për t’i kërkuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që të kontrollojë përjashtimin në rastin konkret.<sup>6</sup>

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”, si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

---

<sup>3</sup>E drejta për akses, sipas pikës 1 të këtij neni, ushtrohet në përputhje me parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes dhe informacionit, lirisë së shtypit dhe sekretit profesional dhe mund të kufizohet, nëse cenon interesat e sigurisë kombëtare, politikën e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale.

<sup>4</sup> Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

<sup>5</sup> Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces.

<sup>6</sup> Në rast se aksesi mohohet, duke argumentuar se cenohen interesat e sigurisë kombëtare, politika e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimi dhe ndjekja e veprave penale ose liria e shprehjes dhe informimit apo liria e shtypit, subjekti i të dhënave mund t’i kërkojë komisionerit të kontrollojë përjashtimin në rastin konkret. Komisioneri informon subjektin e të dhënave për masat e marra.

## **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga Sektori i Burimeve Njërëzore të Gardës së Republikës për t'i dhënë kopjen e dosjes personale shtetasit H.Sh.. Dhënia e kopjes së dosjes ankuesit të pasqyrohet në një dokument zyrtar.
2. Analizimin e këtij rasti, nxjerjen e përgjegjesive ligjore dhe ndëshkimin me masë disiplinore të personave përgjegjës që kanë cënuar të drejtën kushtetues e ligjore shtetasit H.Sh..
3. Përgjithësimin e këtij rasti me qëllim mos përsëritjen e tij në të ardhmen, si me punonjësit e Gardës së Republikës ashtu edhe me persona të tretë që mund t'i drejtohen këtij institucioni me kërkesa për informim lidhur me dokumente zyrtare.

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, të vihemi në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**